

# AKT THEMELIMI

“EcoDES Consultancy” sh.p.k.

Sot në datën 09.04.2021, mbështetur në Kushtetutën dhe Kodin Civil në Fuqi të Republikës së Shqipërisë, të ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare" dhe të ligjit Nr.9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" me vullnetin e tij të lirë, të shprehur edhe në nënshkrimin e këtij akt-themelimi nga ortaku i vetëm:

**Z. Konalsi Gjoka**, i datëlindjes 06.06.1976, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, Rruga Bilal Golemi, Nr.7, Ap.14, Tiranë, shtetas shqipëtar, madhor me zotësi juridike për të vepruar.

## FORMULIMI

### Neni 1

Formohet shoqëria tregëtare private e quajtur “EcoDES Consultancy” sh.p.k. Shoqëria do t’i nënshtrohet legjislacionit Shqipëtar, ndërsa degët që mund të krijohen do t’i nënshtrohen legjislacionit ku do të ketë selinë dega. Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj në bazë të këtij akti themelues dhe statutit të shoqërisë që do të miratohet nga ortakët themelues.

## SELIA E SHOQERISE

### Neni 2

Shoqëria tregëtare private “EcoDES Consultancy” sh.p.k do të ketë selinë e saj në rrugën Bilal Golemi Nr 7, Ap.14, Tirane.

Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra përfaqësie, degë, të krijojë filiale si brenda ashtu dhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të asamblesë dhe ortakut të vetëm të saj.

## OBJEKTIVI I VEPRIMTARISE

### Neni 3

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në fushat e mëposhtme:

- Projektim i instalimeve hidrosanitare, ventilimit, ngrohjes dhe impianteve të trajtimit të ujit.
- Ekspertizë mjedisore, hartim raportesh VNM, auditim.
- Ekspertizë private MNZ për studimin dhe përgatitjen e projekteve mbi masat e mbrojtjes nga zjarri i ndërtesave të çdo lloji. Hartimi i akteve të ekspertizës teknike për zjarret e rena.
- Gërmime dheu me punime eventuale murature e beton arme, prishje dhe punime në tokë të gërmuar.
- Prodhim materialesh inerte, gurë.
- Prodhim elementesh betoni e betonarme të zakonshme, të paranderur, gurë dekorativë.
- Prodhim materialesh me bazë bitumi dhe sintetikë.
- Ndërtime civile, industriale, turistike, bujqësore deri në 5 kate.
- Ndërtime civile, industriale, turistike, bujqësore mbi 5 kate.
- Rikonstruksione, ndërtim rruge, kategoria IV dhe V.
- Punime hekurudhore, ndërtim urash dhe veprash arti deri 10 m.
- Ndërtime portuale, bankina, basene, pontile.
- Ndërtim ujësjellësish, kanalizimesh, kanalesh e impiantesh vaditjeje.
- Ndërtim impiantesh të trajtimit të ujit.

- Ndërtim digash dhe dambash deri 10 m. Sillose, kulla, kulla uji prej b/arme, metalike.
- Punime karpentierie druri.
- Instalimi i impianteve higjienike, kuzhina, lavanteri, hidrosanitare, mirëmbajtja e tyre.
- Punime bojatisjeje, hidroizolim, termoizolim, akustike, kundra zjarrit.
- Furnizim me ujë, kolektorë shkarkimi.
- Projektim ujësjellësish, kanalizimesh urbane, rurale, veprave të trajtimit të ujit.
- Projektim urash dhe veprash arti deri 10 m.
- Sisteme të furnizimit me gas.
- Centrale termike (primare, sekondare).
- Impiante të prodhimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike, si dhe nga burimet e rinovueshme si diellore, era, biomasa, gjeotermia, uji etj.
- Menaxhimi i mbetjeve të ngurta urbane, mbetjeve spitalore, mbetjeve të rrezikshme dhe mbetjeve industriale.

## **KOHEZGJATJA E SHOQERISE**

### **Neni 4**

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë me një afat të pakufizuar. Ajo mund të shpërbëhet në çdo kohë dhe për çfarëdo lloj shkak.

## **KAPITALI I SHOQERISE**

### **Neni 5**

Kapitali fillestar i shoqërisë “EcoDES Consultancy” sh.p.k do të jetë 100.000 (njëqind mijë lekë).

Kapitali është 100% nga kuotat e ortakut të vetëm, i ndarë në 1 kuote.

Kapitali themeltar fillestar mund të shtohet ose të pakësohet (por jo nën vlerën e kapitalit themeltar fillestar).

## **DREJTIMI I SHOQERISE**

### **Neni 6**

Shoqëria do të drejtohet nga administratori i saj, ortakut i vetëm dhe përfaqësuesi ligjor i saj. Ai është përfaqësuesi i Shoqërisë në marrëdhënie me të tretët dhe ka kompetenca të plota në drejtimin e saj. Cdo kontratë do të kryhet prej tij dhe në rast mungese nga një përfaqësues i pajisur me prokurë të posaçme.

### **Neni 7**

Të ardhurat neto të shoqërisë i takojnë ortakut të vetëm.

### **Neni 8**

Ortakut i vetëm themelues ka të drejtë të emërojë dhe administratorë të tjere të vlerave materiale. Ka të drejtë të caktojë financierë, likuidator për problemet e shoqërisë si dhe të pajtojë persona të tjerë si ortakë.

### **Neni 9**

Konfliktet që mund të lindin do të zgjidhen në zbatim të legjislacionit Shqipëtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

### **Neni 10**

Shoqëria ka vulën e saj me madhësi të zakonshme, me tekstin rreth saj.

#### **Neni 11**

Shoqëria deklarohet e krijuar në zbatim të plotë të normave të statutit dhe në përputhje me legjislacionin Shqipëtar në fuqi dhe veçanërisht të Ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 “Për Krijimin e Shoqërive Tregëtare”, si dhe duke zbatuar ligjet ndërkombëtare dhe të vendit si dhe rregullave që zbatohen për biznesin që kryen kjo shoqëri.

#### **Neni 12**

Akti i themelimit u përpilua në 5 kopje, për t'ju shpërndarë organeve kompetente dhe një kopje do të mbetet në dokumentacionin bazë të shoqërisë “EcoDES Consultancy” sh.p.k.

Akti i themelimit nënshkruhet rregullisht nga ortaku i vetëm.

**Ortaku i vetëm themelues i  
“EcoDES Consultancy” sh.p.k**

Konalsi Gjoka



**STATUTI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**" EcoDES Consultancy " sh.p.k**

Shoqëria " EcoDES Consultancy " është themeluar në datën 09.04.2021, bazuar në Ligjin 9901, datë 14.04.2008 " Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare ".

Nënshkruhet ky statut i shoqërisë nga ortaku i vetëm i saj, Z. Konalsi Gjoka.

**Neni 1**

Emri dhe forma

Shoqëria quhet " EcoDES Consultancy ", Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar

**Neni 2**

Selia

Shoqëria e ka selinë në: Rr. " Bilal Golemi ", Nd.7, Ap.14, Tiranë.

Veprimtaria e saj do të shtrihet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe jashtë shtetit. Shoqëria ka të drejtë të krijojë brenda dhe jashtë vendit degë dhe zyra përfaqësimi.

Me vendim të Asamblesë së Përgjithshme mund të krijohen, të ndryshohen ose anulohen (nëse janë të krijuara) degë dhe zyra përfaqësimi brenda dhe jashtë Shqipërisë.

**Neni 3**

Objekti i veprimtarisë

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë:

- Projektim i instalimeve hidrosanitare, ventilimit, ngrohjes dhe impianteve të trajtimit të ujit.
- Ekspertizë mjedisore, hartim raportesh VNM, auditim.
- Ekspertizë private MNZ për studimin dhe përgatitjen e projekteve mbi masat e mbrojtjes nga zjarri i ndërtesave të çdo lloji. Hartimi i akteve të ekspertizës teknike për zjarret e rëna.
- Gërmime dheu me punime eventuale murature e beton arme, prishje dhe punime në tokë të gërmuar.
- Prodhim materialesh inerte, gurë.
- Prodhim elementesh betoni e betonarme të zakonshme, të parandëruar, gurë dekorativë.
- Prodhim materialesh me bazë bitumi dhe sintetikë.
- Ndërtime civile, industriale, turistike, bujqësore deri në 5 kate.
- Ndërtime civile, industriale, turistike, bujqësore mbi 5 kate.
- Rikonstruksione, ndërtim rruge, kategoria IV dhe V.
- Punime hekurudhore, ndërtim urash dhe veprash arti deri 10 m.
- Ndërtime portuale, bankina, basene, pontile.
- Ndërtim ujësjellësish, kanalizimesh, kanalesh e impiantesh vaditjeje.
- Ndërtim impiantesh të trajtimit të ujit.
- Ndërtim digash dhe dambash deri 10 m. Sillose, kulla, kulla uji prej b/arme, metalike.
- Punime karpentierie druri.
- Instalimi i impianteve higjienike, kuzhina, lavanteri, hidrosanitare, mirëmbajtja e tyre.



- Punime bojatisjeje, hidroizolim, termoizolim, akustike, kundra zjarrit.
- Furnizim me ujë, kolektorë shkarkimi.
- Projektim ujësjellësish, kanalizimesh urbane, rurale, veprave të trajtimit të ujit.
- Projektim urash dhe veprash arti deri 10 m.
- Sisteme të furnizimit me gas.
- Centrale termike (primare, sekondare).
- Impiante të prodhimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike, si dhe nga burimet e rinovueshme si diellore, era, biomasa, gjeotermia, uji etj.
- Menaxhimi i mbetjeve të ngurta urbane, mbetjeve spitalore, mbetjeve të rrezikshme dhe mbetjeve industriale.

#### **Neni 4** Kohëzgjatja dhe vula

Kohëzgjatja e shoqërisë është me afat të pakufizuar. Shoqëria ka vulën dhe specimentet e saj.

#### **Neni 5** Të drejtat e ortakëve

Ortakët gëzojnë këto të drejta:

1. Marrin pjesë në drejtimin dhe administrimin e shoqërisë, në përputhje me kontratën dhe statutin e vet ose nëpërmjet përfaqësuesve të saj.
2. Marrin pjesë në rezultatet e veprimtarisë së shoqërisë në çdo formë dhe sasi qoftë në përputhje me statutin.
3. Marrin pjesë në organet e shoqërisë që janë ose mund të krijohen, nëpërmjet përfaqësuesit të saj ose vetë.
4. Të kërkojnë t'u jepen të gjitha informatat që kanë të bëjnë me gjendjen tregtare të shoqërisë si dhe të gjitha dokumentat e përpunuara të shoqërisë, si bilanci, llogaritë ekonomike, etj.
5. Të bëjnë propozime dhe t'i paraqesin ato për shqyrtim para organeve të shoqërisë.
6. Të emërojnë dhe të shkarkojnë përfaqësuesit e saj, punonjësit, ekspertin kontabël dhe likuidatorët.
7. Të heqin dorë nga shoqëria. Heqja dorë nga shoqëria nuk e liron ortakun nga detyrimet financiare të marra më parë ndaj shoqërisë.

#### **Neni 6** Detyrat e ortakëve

Ortakët kanë këto detyra kryesore:

1. Të marrin pjesë në administrimin e shoqërisë nëpërmjet organeve të krijuara prej vetë asaj ose nëpërmjet përfaqësuesve që krijojnë ata.
2. T'i japin shoqërisë informatat e nevojshme që kanë të bëjnë me ecurinë e veprimtarisë së saj.
3. Të kryejnë shërbimet e nevojshme për arritjen e objektivave të shoqërisë dhe realizimin e funksioneve të saj.



## Neni 7

Nëse shoqëria do të përbëhet nga dy a më shumë ortakë, atëhere ortakët kanë të drejtën e parablerjes së kuotave të secilit ortak që dëshiron t'ua tjetërsojë atë të tretëve.

Ortaku që dëshiron të tjetërsojë kuotën e vet, duhet t'u komunikojë me shkrim ortakëve, një shkresë duke u treguar blerësin, çmimin e ofruar dhe mënyrën e pagesës.

Ortakët që çmojnë të ushtrojnë të drejtën e parablerjes, duhet t'i komunikojnë me shkrim përgjigjen, ortakut të interesuar, brenda një muaji nga data e marrjes së njoftimit. Mungesa e komunikimit brenda këtij afati, barazohet me mosushtrimin e të drejtës së parablerjes.

Me mosushtrimin e të drejtës së parablerjes, procedura e transferimit të kuotave të tretët bëhet në zbatim të nenit 17 të këtij statuti.

## Neni 8

### Kontributi i ortakëve të shoqërisë

Kontributi themeltar fillestar i shoqërisë është 100.000 (njëqind mijë) lekë. Ortaku i vetëm themelues është z. Konalsi Gjoka. Numri i pjesëve është 1. Vlera nominale e një pjese është 100.000 (njëqind mijë) lekë.

Ortaku i vetëm z. Konalsi Gjoka është zotërues i 100 % të pjesëve. Kapitali themeltar fillestar do të derdhet në llogarinë bankare të shoqërisë me regjistrimin e shoqërisë.

## Neni 9

### Bilanci

Kur shoqëria pushon aktivitetin e saj, pasi ajo ka shlyer çdo detyrim, pasurinë neto që rezulton nga bilanci i likuidimit, e shpërndan mes ortakëve sipas kuotave të pjesëmarrjes.

## Neni 10

Shoqëria është pronare e pasurisë së saj dhe e përdor atë me qëllim përmbushjen e objektit të veprimtarisë së saj.

Shoqëria gëzon të drejtën e mbrojtjes së pasurive të saj në përputhje me legjislacionin vendas e ndërkombëtar.

## Neni 11

Shoqëria nga fitimi i rezervuar gjatë vitit financiar, pasi të jenë zbritur po të jetë e nevojshme humbjet e vitit të mëparshëm, le mënjane një shumë me vlerë të paktën 1/20 e tij, e cila destinohet për formimin e një fondi rezervë, të quajtur "rezervë e domosdoshme". Çdo vendim i kundërt është i pavlefshëm. Kjo lënie mënjane nuk është e detyrueshme kur "rezerva e domosdoshme" arrijnë 1/10 e kapitalit themeltar.

Veçimi, përdorimi i çdo fondi special përcaktohet nga asambleja në përputhje me legjislacionin shqiptar.



## **Neni 12**

Fitimi që do të shpërndalet, përbëhet nga fitimi i vitit financiar, të cilit i janë zbritur shumat mënjane për rezervën sipas ligjit ose statutit dhe nga ana tjetër me vullnetin e ortakëve, janë zbritur apo shtuar respektivisht humbjet apo fitimet e mbartura nga vitet e mëparshme.

## **Neni 13**

Ushtrimet e shoqërisë mbyllen në 31 dhjetor të çdo fund viti.  
Organi administrativ është i detyruar të përpilojë bilancin, sipas afateve ligjore, i cili duhet të pasqyrojë të gjithë aktivitetin shoqëror dhe të përcaktojë përkatësisht fitimet, humbjet e shoqërisë dhe ndarjen e tyre.

## **Neni 14**

Forma e bilanceve dhe llogarive ekonomike të shoqërisë mbahen nga organet e saj administrative duke respektuar ligjin dhe aktet nënligjore në këtë fushë.  
Kontabiliteti dhe dokumentacioni mbeshitetës arshivohen në shoqëri dhe institucionet perkatëse shtetërore, tatimore, etj.

## **Neni 15**

Transferimet e pjesëve të kapitalit

Transferimet e pjesëve të kapitalit themeltar bëhen me Vendim Asambleje.

## **Neni 16**

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme në rrugë trashëgimie, sipas dispozitave të Kodit Civil.  
Ato janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve.

## **Neni 17**

Pjesët e kapitalit themeltar mund t'u transferohen personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në shoqëri, vetëm me miratimin e shumicës së ortakëve që përfaqësojnë të paktën 51 % të pjesëve të kapitalit themeltar.

Në rast se shoqëria refuzon të japë miratimin e transferimit, ortakët, brenda një muaji nga data e këtij refuzimi, duhet të blejnë apo të lejojnë blerjen e pjesëve të kapitalit themeltar me vlerën që përcaktohet nga një ekspert. Eksperti caktohet nga palët. Kur ata nuk merren vesh ndërmjet tyre, ai caktohet nga gjykata.



**Neni 18**  
Asambleja e Përgjithshme

Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë drejtues dhe vendimor, që ushtron kompetencat e njohura me ligjin “ Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare ”.  
Nëse shoqëria zotërohet nga një ortak, të drejtat dhe detyrimet e Asamblesë së Përgjithshme ushtrohen nga ortaku i vetëm; të gjitha vendimet e marra prej tij regjistrohen në një regjistër të vendimeve.

**Neni 19**  
Thirrja e Asamblesë

Asambleja thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë apo nëpërmjet postës elektronike, jo më vonë se 7 ditë para datës së parashikuar për mbledhjen, duke njoftuar vendin, datën, orën dhe rendin e ditës. Asambleja thirret nga administratori, apo ortakët, të cilët përfaqësojnë të paktën 5 % të totalit të votimeve në Asmblenë e Përgjithshme.  
Asambleja thirret nëse sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton apo ekziston rreziku që aktiviteti i shoqërisë nuk i mbulon detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.

**Neni 20**  
Kuorumi

Kur për marrjen e vendimeve kërkohet shumicë e zakonshme, Asambleja mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë me shumë se 30 % të kuotave.  
Kur për marrjen e vendimeve kërkohet shumicë e kualifikuar, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se 50 % të numrit total të votimeve janë të pranishëm personalisht. Votimi bëhet me shkresë apo mjete elektronike.  
Nëse Asambleja nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumit të lartpërmendur, atëherë ajo mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

**Neni 21**

Në respektim të kërkesave të nenit 20 për kuorumin e duhur të mbledhjeve të Asamblesë, Asambleja vendos me tri të katërtat ( $\frac{3}{4}$ ) e votave të ortakëve pjesëmarrës për ndryshimin e statutit, zmadhimin dhe prishjen e shoqërisë.  
Në raste të tjera, përveç kur parashikohet ndryshe me ligj apo në këtë statut, Asambleja vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës.

**Neni 22**

Votimi mund të jetë i hapur apo i fshehtë. Mënyra e votimit përcaktohet me marrëveshje midis ortakëve.  
Proces-verbalet e mbledhjeve firmosen nga mbajtësi i procesverbalit dhe kryetari. Administratori i shoqërisë është përgjegjës për ruajtjen e proces- verbaleve.



**Neni 23**  
Administrimi

Shoqëria administrohet nga një person fizik, i cili mund të jetë ose jo ortak i shoqërisë. Administratori i shoqërisë do të jetë Z. Konalsi Gjoka. Administratori ushtron funksionin e tij me afat 5 vjet me të drejtë ripërtëritje. Ai mundet që të emërojë përfaqësues me prokurë për akte të veçanta.

**Neni 24**

Administratori ka të gjitha kompetencat për të administruar veprimtarinë tregtare të shoqërisë, si dhe të përfaqësojë atë. Ai ka për detyrë të mbajë dokumentacionin dhe librat kontabël, të përgatisë e nënshkruajë bilancin vjetor, të kryejë regjistrimet në QKR, të raportojë para asamblesë dhe i paraqet asaj dokumentacionin për miratim. Ai ushtron edhe kompetenca të tjera të parshikuara në ligj.

**Neni 25**

Emërimi, shkarkimi i personelit dhe stafit të punës së shoqërisë dhe caktimi i pagës së tyre, përcaktohet me vendim të Asamblesë. Pezullimi nga puna mund të bëhet vetëm nga administratori, deri në marrjen e vendimit përfundimtar nga Asambleja. Marrëdhëniet e punës mes shoqërisë dhe stafit, rregullohen në bazë të Kodit të Punës.

**Neni 26**

Raporti i administrimit, inventaret dhe llogaritë vjetore të hartuara nga administratori, u nënshtrohen miratimit të Asamblese brenda një afati prej 6 muajsh, duke filluar nga data e mbylljes së vitit financiar. Çdo ortak ka të drejtë të paraqesë pyetje me shkrim të cilave administratori duhet t'u përgjigjet në mbledhje. Ortaku ka të drejtë të marrë në çdo moment dokumentat e mësipërm dhe ai mund të ndihmohet nga një ekspert i zgjedhur prej tij.

**Neni 27**  
Kontrolli

Në përputhje me legjislacionin shqiptar që mbulon këtë fushë, shoqëria cakton ekspert kontabël të autorizuar nëse kërkohet nga ligji.

**Neni 28**  
Prishja

Shoqëria prishet:

- Me vendim të Asamblesë së Përgjithshme;  
Me hapjen e procedurave të falimentimit;
- Nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë;



- Me vendim të gjykatës.

### **Neni 29**

#### Likuidimi

Asambleja e Përgjithshme emëron likujduesin; në rastet kur shoqëria priset me vendim gjykate, likujduesi emërohet nga gjykata.

Administratori i shoqërisë njofton QKR për emërimin e likujduesit me të dhënat e tij.

Me hapjen e procedurave të likujdimit, emërtimi i shoqërisë pasohet nga shënimi “ në likujdim e sipër ”.

Likujduesi merr përsipër të drejtat dhe detyrimet e administratorit nga data e emërimit të tij.

### **Neni 30**

#### Çregjistrimi

Shoqëria çregjistrohet nga QKR pasi kryhen të gjitha formalitetet e parashikuara në ligj për mbylljen e likujdimit.

Çregjistrimi bëhet:

- Vullnetarisht nga vetë shoqëria;
- Në bazë të një vendimi gjyqësor të formës së prerë;
- Sipas parashikimit të ligjeve të posaçme.

### **Neni 31**

#### Hyrja në fuqi

Ky statut, i përshtatur në bazë të Ligjit 9901, datë 14.04.2008, hyn në fuqi me nënshkrimin nga ortakët e shoqërisë.

### **Neni 32**

#### Dispozita e fundit

Për çdo gjë që nuk është parashikuar shprehimisht në këtë statut, referimi do të bëhet në Kodin Civil, Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008, “ Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare ”, në Ligjin nr. 9723, datë 03.05.2007 “ Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit ”, në legjislacionin shqiptar në përgjithësi, përfshirë aktet nënligjore. Mosmarrëveshjet që mund të lindin do të zgjidhen me mirëkuptim dhe kur nuk arrihet kjo, do të zgjidhen në rrugë gjyqësore.

Ky statut u hartua në tri kopje origjinale, nga të cilat njëra depozitohet në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, dhe të tjerat mbahen nga vetë shoqëria.

Ky statut pasi u lexua, u kuptua dhe u gjet konform vullnetit të ortakëve të shoqërisë, nënshkruhet prej tyre me vullnet të lirë e të plotë.

**Ortaku i vetëm i shoqërisë “ EcoDES Consultancy ” sh.p.k**

**Konalsi GJOKA**

  
**Konalsi Gjoka**  
